

# NJË DEKADË E MBUSHUR ME DEMOKRACI



## KOSOVA ËSHTË DEMOKRACI

ELHAM (11), ARDIT (10), ESMA (10), EGZONA (10), ELIARTA (10), MUHADIN (10), ARDI (10), KADRI (10)



### 17 shkurt, kjo datë kaq e dashur për ne. E duam me zemër Kosovën tonë dhe do të punojmë për suksesin e saj

Që në lashtësi, poetët e ndryshëm kanë thurur vargje për dashurinë ndaj atdheut. Edhe ne si fëmijë jemi rritur në frymën e dashurisë ndaj vendit tonë, Kosovës. Shumica nga ne kemi lindur në vitin 2007, dhe kemi qenë vetëm në moshën 1 vjeçare në ditën më të rëndësishme të Kosovës sonë të bukur, Ditën e Pavarësisë së saj. Ne nuk e mbajmë mend procesin e pavarësisë dhe momentin kur është shpallur Kosova shtet i pavarur dhe demokratik. Por, ne e dijmë rëndësinë që ka kjo ditë për ne. Edhe për gjeneratat e ardhshme. Që nga ai moment, ne si qytetarë të Kosovës, kemi fituar zyrtarisht lirinë dhe paqen. Kemi fituar të drejtat tona dhe barazinë. Rëndësinë e atij momenti e gëzojmë çdo ditë. Kjo është arsyeja pse ne jetojmë në paqe. Jetojmë të lirë dhe në tolerancë. Jetojmë me solidaritetin dhe barazi. Sepse, këto janë të mirat e demokracisë, që ndryshe njihen si elementet e saja. Ne shkojmë në shkollë të lirë, flasim dhe shprehim mendimet tona lirshëm, zgjedhim udhëheqësit tanë, etj. Këto që i përmendëm janë të drejtat tona. Këto të drejta i gëzojmë të gjithë pa dallime. E çka do të thotë të gëzojmë të drejta pa dallime? Do të thotë se nuk ka rëndësi gjinia, mosha, kombi, feja apo gjendja ekonomike pasi që në demokraci të gjithë trajtoheni të barabartë.

E shihni sa e bukur është demokracia? E shihni sa rëndësi ka për vendin tonë 17 shkurti i vitit 2008? Kjo datë ka shumë vlerë për ne dhe për të gjithë ju. Sigurisht se është mirë ta dini se demokracia ka shekuj që është e pranishme tek njerëzimi. Për herë të parë ajo u paraqit në vitin 507 p.e.s në Greqi. Më saktësisht në Athinën e atëhershme. Koha shpesh ndikon në përmirësimin e gjërave. Edhe demokracia është përmirësuar dhe është plotësuar. Aso kohe nuk kishin të drejtë të votonin gratë. Kurse sot, sot jemi të gjithë të barabartë me të drejta. Andaj, gëzuar pavarësinë o qytetarë demokratikë!

Festojmë  
10 vjetorin e pavarësisë.  
Festojmë së bashku, sepse jemi  
qytetarë të demokracisë dhe gëzojmë  
shumë të drejta



Lumturinë e kemi në zemrat tona. Gëzuar pavarësia!

# MIRATIMI I LIGJIT PËR TË DREJTAT TONA

MELISON (10), AGNESA (11), BLERTON (11), SHKURTE (11), OVEJS (11), SHPEND (9), ELSA (10),  
LORIS (12)



Edhe unë sikurse fëmijët e tjerë, kam të drejtën të shkoj në shkollë dhe të kem një të ardhme të mirë

## Kuvendi sigurohet të na ofrojë ligje të mira

Ne qytetarët e Kosovës kemi tre shtëpi. Shtëpia e parë është vendi ku jetojmë me familjen dhe më të dashurit tanë. Shtëpia e dytë është vendi ku mësojmë që është shkolla dhe shtëpia e tretë është "Shtëpia e Popullit", e që është Kuvendi.

Kuvend është institucioni më i lartë i shtetit tonë. Aty punojnë deputetët, të cilët janë përfaqësuesit tanë. Ashtu siç i votojmë ne deputetët, edhe ata votojnë që të zgjedhin Presidentin, Kryeministrin bashkë me kabinetin qeveritar, Kryetarin e Kuvendit, Avokatin e Popullit, etj.

Kuvendi ka detyra të ndryshme, ku më kryesore janë tri prej tyre, e që ne i quajmë funksione. Funksioni i parë është funksioni përfaqësues, i cili ka të bëjë me përfaqësimin tonë. Funksioni i dytë ka të bëjë me miratimin e ligjeve të ndryshme, të cilat kanë ndikim në fusha të ndryshme të jetës sonë. Funksioni i tretë ka të bëjë me kontrollimin e punës së Qeverisë.

Në vazhdim do të flasim pak për ligjet. Ligjet janë rregulla të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, e që ne si qytetarë të përgjegjshëm duhet t'i respektojmë dhe t'i zbatojmë ato. Në Kosovë ka ligje të ndryshme, por meqenëse ne jemi fëmijë, jemi fokusuar në ligjin që i mbron të drejtat tona.

Ne jemi dëshmitarë të shumë rasteve kur fëmijët keqtrajtohen dhe obligohen të bëjnë punë të ndryshme

pa dëshirën e tyre.

Duam ta ndajmë me juve një skenë të cilën e kemi parë rrugëve të qytetit tonë, pra në Viti. Ishte një moment shumë i papëlqyer nga ne, kur tek sa po shkonim në shkollë, e kemi parë një bashkëmoshatar tonin i cili po kërkonte lëmshë. Ne donim ta ndihmonim atë, duke e ditur se në demokraci të gjithë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të gjithë duhet të ndihen se po trajtohen në këtë mënyrë. Këtë edhe e realizuam, duke i ndihmuar familjes së djaloshit dhe duke ua bërë me dije se të drejtat e fëmijëve duhet të mbrohen gjithmonë. Këtë fakt e kemi mësuar ndër vite, por sot e mësoam edhe njëherë që në shtetin tonë kemi një ligj i cili lidhet pikërisht me të drejtat tona dhe kjo na bën shumë të lumtur, sepse ne duam që çdo fëmijë kudo që jeton, të gëzojë të drejta, sikurse edhe ne.




Të drejtat tonë mbrohen me ligj






Shikojeni vizatimin tonë me anë të së cilët kemi paraqitur planetin Tokë. E shihni si është i gjelbëruar dhe dielli shkëlqen? Kjo sepse të gjithë punojmë në ruajtjen e ambientit. Të mos harrojmë se duke u kujdesur për shtëpinë, lagjen dhe qytetin tonë, ne kujdesim edhe për planetin tonë



Ana dhe Anisi janë shokë të ngushtë të lagjes. Ata e dijnë se i kanë të drejtat e barabarta dhe e respektojnë njëri-tjetrin. Kështu bëjnë qytetarët e demokracisë

Ambient i pastër nënkupton trup të shëndoshë dhe shëndet të mirë. Ne e kemi në dorë ruajtjen dhe pastrimin e ambientit



Ne shpresojmë që sa më pak persona të kenë nevojë për ndihmë mjekësore. Megjithatë, duam t'iu rikujtojmë se kujdesi shëndetësor është e drejta jonë. Sigurisht se edhe të punosh është shumë mirë. I shihni këto lule punëtoresh dhe të bukura? Edhe ne jemi të tillë

## LIRIA PËR TË ZGJEDHUR

AHMET (10), BLEND (11), ANESA (10), ENDRIT (11), ARJETON (11), SAMIR (11), ERLINDA (11),  
FIXHIRIJE (12)



### Jemi shumë të lumtur që e kemi të drejtën e zgjedhjes në demokraci

Fjala demokraci do të thotë qeverisje nga populli. Në demokraci, të gjithë qytetarët e kanë të drejtën e zgjedhjes. Kemi shumë shembuj nga jeta jonë e përditshme për këtë të drejtë. Ishte një ditë pranvere, dhe mësuesja na tha që të dalim në kopsht për të luajtur. Kështu, ne kishim shumë preferenca për lojërat që dëshironim t'i luanim. Për shkak të mendimeve të ndryshme, vendosëm që të vepronim sikur në procesin zgjedhor, kur popull i zgjedh përfaqësuesit e vet. Pra, votuam dhe e zgjodhëm lojën që mori më së shumti vota. Për të ilustruar procesin e votimit, një nxënës i tregonte shoqëve dhe shoqeve mënyrën e votimit, kurse një tjetër ndërtonte kutinë e votimit. Votat ishin të fshehta, por njëri nga nxënësit u ngrit në këmbë dhe tregoi votën e tij. Të gjithë u habitën, nga veprimi i tij. Prandaj, ne i treguam shokut arsyet e votës së fshehtë dhe ai na dha fjalën që nuk do të ndodhte më. Pastaj, gjithçka u rregullua dhe votuam ashtu siç duhej. Për të votuar në procesin zgjedhor ne duhet t'i kemi 18 vjet, sepse atëherë jemi më të pjekur dhe më të vetëdijshëm për vendimet tona.

Vota sjell ndryshimin, prandaj qytetarët duhet ta marrim me shumë përgjegjësi të drejtën e votës. Kjo arrihet duke marrë pjesë në procesin zgjedhor, dhe duke i votuar përfaqësuesit e vendit.



Sikurse flutura që fluturon, edhe ne në demokraci jemi të lirë të veprojmë, të shprehim mendimet tona dhe t'i zgjedhim gjërat që neve na pëlqejnë



Ne jemi autorët e këtij artikulli. Me shumë përkushtim kemi vizatuar, shkruar dhe kemi dhënë ide se çfarë të shkruanim. Shpresojmë që do ta pëlqeni





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Bafti Haxhiu“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-3  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Viti